

**KONFERENCA SHKENCORE “REMZI PËRNASKA –
PERSONALITET I GJUHËSISË SHQIPTARE”, ELBASAN,
24 PRILL 2015**

Në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Fakulteti i Shkencave Humane, më 24 prill 2015 u organizua konferenca shkencore kombëtare “Remzi Përnaska – Personalitet i gjuhësisë shqiptare”. Ky aktivitet erdhi në vazhdim të organizimit të veprimtarive shkencore për nder të figurave të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare. Në të morën pjesë akademikë, kolegë e dashamirë të prof. Remzi Përnaskës, si dhe familjarë të tij.

Konferenca hapi punimet në sallën e bibliotekës së universitetit me fjalën përshëndetëse nga rektori i UE “A. Xhuvani” z. Liman Varoshi. Në vijim mbajtën fjalën e tyre përshëndetëse i dërguari i Ambasadës Franceze në Tiranë dhe z. Albert Riska nga departamenti i gjuhësisë, UE “A. Xhuvani”. Moderatore e konferencës ishte Teuta Toska. Konferenca ishte organizuar në dy seanca.

Në seancën plenare u mbajtën këto kumtesa: *Jeta dhe veprimtaria shkencore e prof. R. Përnaskës*, referat nga Mehmet Çeliku; *Traditë dhe risi në studimet sintaksore të prof. Remzi Përnaskës*, nga Seit Mansaku; *Koncepti i trajtave të shkurtra në optikën shkencore të R. Përnaskës*, nga Enver Hysa; *Probleme të kulturës*

së gjuhës në studimet e Përnaskës, nga Emil Lafe; *Fjalori shqip-frëngjisht i prof. Remzi Përnaskës – vepër madhore e leksikografisë sonë dygjuhëshe*, nga Hajri Shehu; *Kundranori me parafjalë në gjuhën e sotme shqipe – vepër me rëndësi të madhe për sintaksën e shqipes*, nga Anila Kananaj; *Rreth ndihmesave të prof. Remzi Përnaskës në tekstet e gjuhës shqipe të arsimit parauniversitar*, nga Ali Jashari dhe Abdulla Ballhysa; *Përshtypje nga leksionet e prof. Përnaskës, viti 1972-1973*, nga Kujtim Kapllani.

Në seancën e dytë u mbajtën kumtesat në vijim:

Probleme të gjymtyrëzimit aktual në studimet sintaksore të R. Përnaskës, nga Thoma Dhima; *Remzi Përnaska për kundrinorin në gjuhën shqipe*, nga Ludmila Buxheli; *Disa reflektime mbi trajtimet në rrafshin filozofik gjuhësor të prof. Përnaskës*, nga Albana Ndoja; *Shqipja dhe gjuhësia e përgjithshme nën këndvështrimin e prof. Përnaskës*, nga Leonard Dauti; *Mjetet gramatikore në gjuhën shqipe dhe emërtimi i tyre*, nga Mustafa Karapinjalli; *“Kufijtë e gjuhës sime janë kufijtë e botës sime”*, mendime mbi raportin gjuhë – mendim të Remzi Përnaskës dhe më gjerë, nga

Emine Sadiku; *Rreth vlerave kohore të disa kohëve të foljes në gjuhën shqipe*, nga Tomor Plangarica; *Mbi mendimet e Përnaskës për trajtat e shkurtra dhe gjymtyrëzimin aktual në shqipe*, nga Enkeleida Kapia; *“Parlons albanais” dhe disa aspekte në përvijim e sipër të shqipes si gjuhë e huaj*, nga Jonida Xhyra; *Statusi sintaksor i disa ndërtimeve parafjalore*, nga Flora Koleci; *Shkrimi si një sistem tjetër në konceptin e normës në punimet e prof. Përnaskës*, nga Teuta Toska.

Kjo konferencë, nëpërmjet kumtesave dhe diskutimeve, vuri në pah ndihmesat më të rëndësishme të

prof. Remzi Përnaskës në fushat e leksikografisë dygjuhëshe dhe të sintaksës, si dhe kontributin e tij si mësues e pedagog i përkushtuar i arsimit shqiptar. Profesor Remzi Përnaska është sintaksolog i njohur në gjuhësinë shqipe, në veprimtarinë shkencore të të cilit spikat në mënyrë të veçantë monografia *Kundranori me parafjalë në gjuhën e sotme shqipe* (1996), ku ka sjellë vështrime të reja me interes për sintaksën shqipe.

Në mbyllje të konferencës, prof. Përnaska u shpërndau pjesëmarrësve të konferencës librin e tij më të ri, të sapodalë nga shtypi, *Gjuhësi... gjuhësore* (2015).

Anila Kananaj